

I. Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson drejtori z. Mahmoud Abbas Shaker, tutje referuar si pala e parë dhe:

II. Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson kryetari z. Xhafer Tahiri, tutje referuar si pala e dytë.

Më datën: 10/03/2021, lidhin këtë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Objekti i Memorandumit

Objekt i këtij memorandumi është shpërndarja e dyqind (200) pakove me artikuj ushqimorë dhe mbulesa dimërore, në Komunën e Vushtrrisë për familjet me kushte të rënda ekonomike.

Neni 2

Obligimet e palës së parë

Pala e parë Organizata "QATAR CHARITY" merr përsipër shpenzimin direkt për realizimin e këtij projekti në vlerë prej tetë mijë e katërqind e tetë euro (8.408€).

Neni 3

Obligimet e palës së dytë

Pala e dytë merr përsipër sigurimin e listave me të propozuarit, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, duke i përmbushur kriteret kryesore për secilën familje si: 1) Kushtet e rënda ekonomike, 2) T'i ipet përparsi familjeve të kryesura nga femrat, 3) Të mos kenë pasur apo të mos kenë probleme ligjore.

Pala e dytë – Komuna e Vushtrrisë, është përgjegjëse për sigurimin e vendit në ditën e implementimit të projektit, mbajtjen e rendit konform rregullave anti-covid, si dhe, përmbushjen e nevojave tjera teknike dhe logjistike në rast nevojë.

Neni 4

Gjatë shpërndarjes, për qëllime të transparencës do të bëhet fotografimi i përfituesve, si dhe evidentimi i tyre në listën e përfituesve. Fotografitë nuk do të keq-përdoren nga asnjëra palë.

Neni 5

Të përgjithshme

Palët nënshkruese pajtohen për pikat si në vijim:

- Respektimi i të drejtave të fëmijës, mbrojtja e grupeve të marginalizuara dhe mos lejimi i ndonjë pale të shfrytëzojë ato apo të shkelë të drejtat e tyre;
- Respektimi i parimit të transparencës dhe rregullave të anti-korrupsionit dhe nepotizmit;
- Respektimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare;
- Respektimi i ligjit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me pastrim parash, apo financim të terrorizmit.

Neni 6

Zgjidhja e paqartësive


Palët nënshkruese pajtohen që në rast të ndonjë paqartësie eventuale në mes palëve nënshkruese sa i përket realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi, zgjidhja të bëhet me mirëbesim dhe biseda të ndërsjella mes tyre.

Neni 7

Ky memorandum është i lidhur në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mban nga një (1) kopje.

Nënshkruajnë:

Drejtor i organizatës "Qatar Charity"
z. Mahmoud Abbas Shaker



قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office



Kryetar i Komunës së Vushtrisë
z. Xhafer Tahiri

